



REPUBLIKA E KOSOVËS
REPUBLIKA KOSOVA – REPUBLIC OF KOSOVO

GJYKATA KOMERCIALE
DHOMAT E SHKALLËS SË DYTË

K.Dh.Sh.II.nr.651/23

GJYKATA KOMERCIALE – Dhomat e Shkallës së Dytë, gjyqtari Krenar Berisha, në çështjen juridike përmbartimore të kreditorit Kompania Rajonale e Mbeturinave “Pastrimi”. Sh.A., me seli në Prishtinë, kundër debitorit “Oti – Com” ShPK, me pronar Xh.Rr nga Lipjani Rr. ... p.n, për shkak të borxhit sipas dokumentit të besueshëm - ekstraktit të verifikuar nga librat afarist, duke vendosur lidhur me ankesën e debitorit të ushtruar kundër aktvendimit të Gjykatës Komerciale të Kosovës – Dhoma e shkallës së parë, Departamenti për Çështje Ekonomike, KPPP.nr.476/22 të datës 18.08.2022, me datën 06.02.2024, mori këtë:

A K T V E N D I M

REFUZOHET si e pathemeltë ankesa e debitorit Oti – Com shpk, me pronar Xh.Rr nga Lipjani Rr. ... p.n., ndërsa aktvendimi i Gjykatës Komerciale të Kosovës – Dhomat e shkallës së parë, Departamenti për Çështje Ekonomike, KPPP.nr.476/22 i datës 18.08.2022, VËRTETOHET.

A r s y e t i m

Gjykata Komerciale e Kosovës – Dhomat e shkallës së parë, Departamenti për Çështje Ekonomike me aktvendimin e atakuar KPPP.nr.476/22, i datës 18.08.2022, në pikën I. të diapozitivit e ka Aprovuar pjesërisht prapësimin e debitorit Oti – Com” ShPK, me pronar Xh.Rr nga Lipjani Rr. ... p.n., dhe ka shfuqizuar Urdhrin e Përmbartuesit Privat me numër P.nr.1511/2018 të datës 12.11.2018 sa i përket kamatës 8% si dhe shumës 305.40€, ndërsa në pikën II. të dispozitivit e ka Refuzuar si të pabazuar prapësimin e debitorit të përmbartimit, sa i përket kërkesës objekt i përmbartimit në shumën prej 766.96€ dhe për këtë shumë urdhri për caktimin e përmbartimit P.nr.1511/2018 të datës 12.11.2018, mbetet në fuqi.

Kundër aktvendimit të lartcekur, brenda afatit ligjor, ankesë ka parashtruar debitori për shkak të shkeljeve esenciale të dispozitave të procedurës përmbarimore, për shkak të vërtetimit të gabuar dhe jo të plotë të gjendjes faktike dhe për shkak të zbatimit të gabuar të drejtës materiale, me propozimin që të aprovohet ankesa si e bazuar dhe të ndryshohet aktvendimi i ankimuar i Gjykatës Komerciale të Kosovës - Dhomat e Shkallës së Dytë, KPPP.nr.476/22, i datës 18.08.2022 për shkak të arritjes së parashkrimit dhe propozimi për përmbarim të refuzohet si i pabazuar për shkak të parashkrimit.

Kreditore nuk ka ushtruar përgjigje në ankesën e debitorit.

Gjyqtari individual i Gjykatës Komerciale - Dhomat e shkallës së Dytë, i shqyrtoi shkresat e lëndës, aktvendimin e atakuar dhe pretendimet ankimore, në kuptim të nenit 3, paragrafi 2, të Ligjit nr.04/L-139 për Procedurën Përmbarimore si dhe në kuptim të nenit 194 dhe 208 të Ligjit për Procedurën Kontestimore (LPK) dhe gjeti se:

Ankesa e debitorit është e pathemeltë.

Nga shkresat e lëndës rrjedh se kreditore me datën 09.11.2018, ka paraqitur propozim për përmbarim ndaj debitorit në bazë të dokumentit të besueshëm – ekstraktit të verifikuar të librave afarist për periudhën e përmbushjes nga data 01.01.2014 deri me datë 31.10.2018 për shumën e borxhit prej 1,072.04 €.

Kundër urdhrimit mbi lejimin e përmbarimit debitori ka paraqitur prapësim me të cilën ka kërkuar që të anulohet urdhri për përmbarim. Duke vendosur mbi prapësimin e debitorit, gjykata e shkallës së parë ka nxjerr aktvendimin e ankimuar KPPP.nr.476/22, të datës 18.08.2022, me të cilin në pikën I. të diapozitivit e ka Aprovuar pjesërisht prapësimin e debitorit Oti – Com” ShPK, me pronar Xh.Rr nga Lipjani Rr. ... p.n., dhe ka shfuqizuar Urdhrin e Përmbaruesit Privat me numër P.nr.1511/2018 të datës 12.11.2018 sa i përket kamatës 8% si dhe shumës 305.40€, ndërsa në pikën II. të dispozitivit e ka Refuzuar si të pabazuar prapësimin e debitorit të përmbarimit, sa i përket kërkesës objekti i përmbarimit në shumën prej 766.96€ dhe për këtë shumë urdhri për caktimin e përmbarimit P.nr.1511/2018 të datës 12.11.2018, mbetet në fuqi. Në arsyetim të aktvendimit, theksohet se prapësimi i debitorit duhet të aprovohet pjesërisht si e bazuar pas konstatimit se në këtë pjesë borxhi i kërkuar me detyrim është parashkruar, për faktin se kreditore propozimin për përmbarim e ka paraqit me datën 12.11.2018 ndërsa sipas nenit 355 par.1 pika

1.1 të LMD-së, kreditori e ka humbur të drejtën për të kërkuar realizmin me detyrim të kërkesës së arritur për pagesë nga data 09.12.2015 në shumën prej 305.40€, kjo ngase në kartelën e konsumatorit gjykata vërejt se pagesa e fundit e debitorit ishte bërë me datën 25.11.2015 dhe borxhi tjetër i akumuluar fillon të rrjedh për pagesë nga data 09.12.2015. Parashkrimi i shërbimeve sipas raporteve kontraktuale të palëve, gjen zbatim neni 355 i LMD-së dhe jo neni 360 i njëjtit Ligj. Meqë kreditori me propozimin për përmbarrim dt.12.11.2018 ka kërkuar borxhin për periudhën 09.12.2015 deri 12.11.2018, gjykata pas vlerësimit të afateve të parashkrimit lidhur me kartelën e konsumatorit, ka gjetur se borxhi i faturuar për këtë periudha nuk është parashkruar ngase afati i parashkrimit për kërkesat reciproke në raportet komerciale parashkruhen për 3 vite.

Gjykata Komerciale - Dhomat e Shkallës së Dytë, vlerëson se dhoma e shkallës së parë në bazë të provave të cilat i ka pasur në dispozicion në shkresat e lëndës, ka marr aktvendimin e saj të drejtë dhe të bazuar në dispozitat e procedurës përmbarrimore. Gjykata e shkallës së parë me të drejtë ka konstatuar se pas shqyrtimeve të pretendimeve për prapësim të debitorit të përmbarrimit dhe analizimit të shkresave në lëndë, ka gjetur se prapësimi i debitorit të përmbarrimit dhe analizimit të shkresave në lëndë, duhet të aprovohet pjesërisht si i bazuar dhe ka vendosur si në pikën I të dispozitivit, pas konstatimit se në këtë pjesë borxhi i kërkuar të realizohet me detyrim është parashkruar, për faktin se kreditori i përmbarrimit për propozim përmbarrimin e ka paraqitur me datë 12.11.2018, ndërsa sipas nenit 355 par.1 pika 1.1 të LMD-së është rregulluar se: *“Kërkesa reciproke nga kontrata komerciale si dhe kërkesa e shpërblimit të shpenzimeve të bëra lidhur me këto kontrata, parashkruhen për tri (3).”* Tutje thuhet se *“Parashkrimi rrjedh veç e veç për çdo dërgim të mallit, pune ose shërbimi të kryer.”* Sipas neneve të sipërcituara të LMD-së, rrjedhimisht kreditori i përmbarrimit e ka humbur të drejtën për të kërkuar realizmin me detyrim të kërkesës së arritur për pagesë nga data 09.13.2015 në shumë prej 305.40€, kjo ngase në kartelën e konsumatorit gjykata vërejt se pagesa e fundit e debitorit të përmbarrimit ishte bërë me datë 25.11.2015 dhe borxhi tjetër i akumuluar fillon të rrjedh për pagesë nga data 09.12.2015. Gjykata pas vlerësimit të afateve të parashkrimit lidhur me kartelën e konsumatorit të lartpërmendur, ka gjetur se pagesat e shënuara në këtë kartelë deri me datën 09.12.2015 janë parashkruar, ngase afati i parashkrimit për kërkesat reciproke nga kontratat komerciale si dhe kërkesat e shpërblimit të shpenzimeve të bëra lidhur me këto kontrata, parashkruhen për tri vite, andaj vendosi si në pikën I të këtij Aktvendimi.

Së këndejmi, Dhoma e Shkallës së Dytë e Gjykatës Komerciale vlerëson se gjykata e shkallës së parë drejtë ka vlerësuar edhe pjesën tjetër të borxhit në shumë prej 766.96 € për të cilën ka

vlerësuar se nuk është parashkruar dhe rrjedhimisht ka vendosur si në pikën II të dispozitivit të atakuar, duke e lënë në fuqi urdhrin për përmbarim. Kjo për faktin se gjykata e shkallës së parë drejtë ka aplikuar dispozitat materiale të Nenit 355 të LMD-së kur e ka llogaritur afatin tre vjeçar të parashkrimit për kërkesat periodike të cilat rrjedhin vit pas viti, e cila dispozitë gjen zbatim te subjektet juridike.

Gjykata ka vlerësuar pretendimet ankimore të debitorit se ekstrakti nga librat e kontabilitetit nuk janë të nënshkruara nga debitori, dhe si të tilla nuk mund të shërbejnë si titull ekzekutiv, mirëpo këto pretendime nuk gjejnë mbështetje ligjore sepse dispozita e nenit 29 par.1 pika 1.2 e LPP-së, parasheh ekstraktet nga librat afariste si dokumente të besueshëm në realizmin e përmbarimit. Nga pretendimet ankimore dhe në shkresat e lëndës, kjo gjykatë nuk gjeti prova që dëshmojnë se borxhi është parashkruar në tërsi.

Nga arsyet e paraqitura me lartë, Dhomat e shkallës së dytë vendosi si në dispozitiv të këtij aktvendimi në pajtim me nenin 208 dhe 209 pika b) të LPK-së, e lidhur me nenin 17 dhe 77 të LPP-së.

GJYKATA KOMERCIALE e KOSOVËS

Dhomat e Shkallës së Dytë

K.Dh.sh.II.nr.651/23 datë 06.02.2024

Gjyqtari
Krenar Berisha